



THIRRJE PËR PJESËMARRJE
NË
KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE

“KUJTESA KOLEKTIVE NË LETËRSI DHE MEDIA”

Data: 12 maj 2022

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Letërsi – Gazetari
Elbasan**

Në bashkëpunim me:

**Scuola di scienze politiche “Cesare Alfieri”,
Università degli studi di Firenze Italia
Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Universiteti i Tiranë
Departamenti i Letërsisë, Universiteti i Tiranës
Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë**



UNIVERSITÀ
DEGLI STUDI
FIRENZE



Qëllmi i kësaj konference është që të ofrojë këndvështrime të reja për dilema të vjetra që kanë të bëjnë me fushën e kujtesës kolektive kryesisht në letërsi dhe në media, në mënyrë që të zgjerojë studimet në fushë duke shtruar pyetje që fokusohen në ndërlidhjet mes formësimit të kujtesës kolektive dhe rolit të letërsisë dhe masmedias në ndryshimin e konteksteve politike, sociale dhe kulturore.

Akset kryesore përfshijnë, por nuk janë të kufizuara vetëm në:

- Roli i masmedias në formësimin e kujtesës kolektive
- Historia nga dritarja e medias si reflektim i politikave editoriale
- Kujtesa e letrarizuar
- Kujtesa kolektive në epokën digjitale
- Përdorimet dhe keqpërdorimet e kujtesës
- Kujtesa politike dhe politika e kujtesës: Rikontekstualizimi i së shkuarës në shërbim të së sotmes dhe të ardhmes
- Letërsia si medium i kujtesës kulturore
- Kujtesa kolektive dhe identiteti kombëtar
- Kujtesa si formë e harresës – mbi manipulimin e kujtesës
- Kujtesa dhe identiteti kulturor folklorik
- Kujtesa dhe mitologjia – krijimi i miteve si produkt i kujtesës kolektive
- Kujtesa kolektive dhe tradita orale

Drejtimet e mësipërme do të prezantohen në katër panele si më poshtë:

1. Politika e kujtesës: Kujtesa si fenomen kolektiv mund të shqyrtohet në vlerën e veçantë politike që ajo mbart; në mënyrë të veçantë do të inkurajohen punimet që hedhin dritë në marrëdhëniet midis identitetit dhe kujtesës, në rishkrimin politik të së shkuarës, në marrëdhënien midis kujtesës dhe atdheut.

2. Shkrimi i kujtesës: Ky seksion do t'i kushtohet trajtimit të kujtesës si hapësirë letrare, nga epika te autobiografia, duke kaluar nëpër romanin historik. Do të inkurajohen gjithashtu kontributet që fokusohen në rolin e kujtesës si lajtmotiv letrar dhe filozofik në veprën e shkrimtarëve, intelektualëve dhe poetëve.

3. Kujtesa kolektive në media: E thënë ndryshe, kujtesa kolektive është në thelb një fenomen i ndërmjetësuar. Kujtimet kolektive nuk ekzistojnë në mënyrë abstrakte. Prania e tyre dhe ndikimi që kanë mund të dallohen vetëm nëpërmjet përdorimit të tyre të vazhdueshëm. Nuk mund të ketë "kujtesë kolektive" pa një manifestim publik, prandaj ky seksion do të mbledhë studime mbi kujtesën që fokusohen në forma të ndryshme të shfaqjes publike si p.sh ritualet, përkujtimet ceremoniale dhe tekstet e masmedias.

4. Kujtesa e të shenjtës: Mitologjia, paganizmi dhe monoteizmi kanë një marrëdhënie të dallueshme me historinë e së kaluarës si nga pikëpamja teologjike, ashtu edhe nga ajo praktike-rituale. Ky seksion do të mbledhë kontribute që synojnë të hulumtojnë marrëdhënien midis të shenjtës dhe kujtesës, një temë që mund të trajtohet si nga pikëpamja e filozofisë së fesë dhe teologjisë, ashtu edhe nga ajo e studimeve kulturore.

Data të rëndësishme:

Dërgimi i abstraktit:	deri më 31 mars
Dërgimi i panelit (me 5-6 abstrakte):	31 mars
Përgjigjet për miratimin e abstrakteve/panelit:	06 prill
Dërgimi i punimeve të plota për botim:	6 maj
Konferenca:	12 maj

Informacione kryesore:

Për informacione mbi pagesën e regjistrimit, kontakto: filip.gosja@uniel.edu.al

Mënyra e pjesëmarrjes: Prani fizike individuale në mjediset e Universitetit të Elbasanit

Detajet e abstraktit:

Titulli

Abstrakt (250 - 300 fjalë në shqip dhe anglisht)

Fjalë kyç (5)

Autori/e (t)

Përshkrim i shkurtër i autorit/autore

Ju lutem dërgoni propozimet tuaja në e-mailin: letersi.gazetari@uniel.edu.al

Kohëzgjatja e prezantimit: 15 min.

Lloji i pjesëmarrjes:

Individual: dërgim i abstraktit 200-250 fjalë dhe një përshkrim i shkurtër në emailin: letersi.gazetari@uniel.edu.al

Grupor: Propozuesi i panelit duhet të dërgojë emrin e tij si drejtues i panelit bashkë me 5-6 abstrakte të pjesëmarrësve që ai i gjen dhe e dërgon panelin e propozuar për miratim në Komitetin shkencor, në emailin: letersi.gazetari@uniel.edu.al

Gjuha e konferencës: shqip, anglisht, italisht

Publikime:

Punimet e përzgjedhura (4-7 mijë fjalë) do të publikohen në një botim të veçantë pas recensimit sipas kriterëve përkatëse për botimet shkencore.

Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

Për dërgimin e materialeve si dhe çdo pyetje lidhur me konferencën, ju lutem të mos hezitoni të kontaktoni në adresën e e-mailit: letersi.gazetari@uniel.edu.al

Komiteti shkencor:

Dr. Nirvana Shkëlzeni – Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan, Shqipëri
Prof. As. Dr. Luçiano Boçi - Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan, Shqipëri
Dr. Silvia Pezzoli – Università degli Studi di Firenze, Italy
Dr. Sheyla Moroni - Università degli Studi di Firenze, Italy
Prof. As. Dr. Mark Marku, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Dr. Rrapo Zguri, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Persida Asllani, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. Dr. Dhurata Shehri, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
Prof. As. Dr. Hasan Saliu – Kolegji AAB, Kosovë
Prof. As. Dr. Gazmend Abrashi – Kolegji AAB, Kosovë
Dr. Ardita Reçi – Kolegji AAB, Kosovë

Ju mirëpresim!

Për Komitetin Organizues të Konferencës

Dr. Nirvana Shkëlzeni

**Përgjegjës i Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë
Fakulteti i Shkencave Humane
Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan**